



VENDIM

Nr. 129, Datë 29.07.2016

MBI

ANKIMIN ADMINISTRATIV TE OST SH.A NDAJ VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR 103, DATË 23.06.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 16 pikat 1 dhe 5, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 16, të “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të dates 29.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e OST sh.a. për anulimin Vendimit Nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me anë të shkresës Nr. 4207 Prot., date 17.07.2016, i është drejtuar ERE-s, me një ankim administrativ mbi vendimin Nr. 103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s.
- Vendimi 103, date 23.06.2016 i është komunikuar shoqërisë OST sh.a. nëpërmjet shkresës Nr 496 Prot datë 29.06.2016 të ERE-s.
- Mbështetur në nenin 16 pika 5 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenin 16 të “Rregullores për organizimin,

funkcionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE: *Për një Vendim te Bordit, Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni te vendimit.*

- Kërkesa e OST sh.a. për anulimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr 103, datë 23.06.2016 është depozituar në ERE jashtë afateve ligjore.
- OST sh.a. konstaton vështirësi për implementimin e plaformës IT-Online.
- Bordi I ERE në pikën 2 të vendimit Nr 103, datë 23.06.2016 ka parashikuar se “Rregullorja” hyn në fuqi, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- Nuk është paraqitur asnjë provë e re që të cojë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga Vendimi Nr 103 datë 23.06.2016 I Bordit të ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së Shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit Nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.